

INTERVISTË ME SEVİM BAKI

Prishtinë | Data: 13 janar 2019

Kohëzgjatja: 72 minuta

Të pranishëm:

1. Sevim Baki (E intervistuar)
2. Ebru Süleyman (Intervistuesja)
3. Donjeta Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Sevim Baki: Unë jam Sevim Baki, e lindur në Prishtinë, 1972-tën. Rrjedh prej një familjes turke, jam vajza e tretë e gazetarit, shkrimtarit Enver Baki dhe Remzije Baki nga Vushtrria. Pas meje e kam edhe një vëlla. Siç thash vijmë prej një familjes turke, gjithmonë turqisht kemi folur, turqisht jemi arsimuar, më tutje kur të bisedojmë ngadal, ngadal do t'ju tregoj përse e përfundova shkollën e mesme dhe universitetin në gjuhë të ndryshme.

Ebru Süleyman: Po, nëse doni mund të flasim pak për fëmijërinë tuaj? Ku e keni kaluar fëmijërinë? Në cilën lagje, në cilat pjesë të Prishtinës?

Sevim Baki: Po, në fëmijëri siç thash kemi qenë katër fëmijë në familje. E mbaj në mend shumë mirë kemi qenë në rrugën “Vëllazërim Bashkimi” numër 37 që është konsideruar qendër (buzëqesh). Më e rëndësishmja ishte se e kishim shtëpinë afër lumit Prishtevka, i cili fatkeqësisht është mbyllur dhe gjithashtu shtëpinë e kishim 15-20 metra larg prej shkollës fillore “Meto Bajraktari”. Çdo vend e kishim afër, për familjen tregu, posta, qendra e shëndetësisë, për fëmijët shkolla, çdo gjë, për fat të mirë çdo gjë e kishim afër. Fëmijëria shumë mirë na ka kaluar, me motrat ishim shumë afër me moshë domethënë brenda katër viteve jemi lindur, e para ‘69-tën, unë ‘72-tën, domethënë të tri vajzat ishim pothuajse moshatare dhe kjo ishte një gjë shumë e mirë, një avantazh, sepse të gjitha u rritëm si shoqe, rrobat i kishim të përbashkëta, lojërat e përbashkëta, edhe shoqet gjithmonë i kishim të njëjta, vetëm se njëra prej neve shkonte në klasën e parë, tjetra në të dytën, tjetra në të tretën. Edhe vëllau poashtu u lind ‘73-tën.

Sa e mbaj në mend isha fëmijë i vogël topolak, i ndrojtur, dhe i qetë. Kur i shikoja fotografitë por edhe nëna më tregonte, gjithmonë topolake e bardhë dhe nëna flokët gjithmonë mi rregullonte në topuz, kështu i thoshim atij modeli të flokëve {shpjegon me duar} i bënin kështu. Për shkak se isha shumë e bardhë, shumë mirë më kujtohet gjyshi Sadik ma dha nofkën pambuk Sevim. Madje në të gjitha shkrimet e babait unë nuk njihem si Sevim, por si pambuk Sevim. Për këtë mua më së shumti më fliste halla e babait Habibja, e cila jetonte në Shkup por vinte shpesh tek ne, domethënë motra e gjyshit tim halla Habibe mua gjithmonë më tregonte, me siguri pasi që e përkujtonte vëllaun përmes asaj nofkës sime.

Siç thash shkollën e kishim shumë afër, për shembull shtëpinë e kishim në mes dhe nga njëra anë kishim urë, në anën tjetër një urë, domethënë për të shkuar në shkollë majtas dhe djathtas i kishim urat e vjetra. Lumin Prishtevka e kishim menjëherë aty përpara, lagje e baltosur ka qenë, më kujtohet

shpesh herë nëna kur ankohej “Kur do të shpëtojmë më prej kësaj balte, po i laj çizmet e fëmijëve shumë herë në ditë...” Por, siç e dini, të gjithë i kishin rrugët me baltë atëherë, për shkak të lumit. Mbj mend gjithashtu edhe urat shumë mirë, ato gjithnjë rrëzoheshin. Ne i dëgjonim ato brenda në shtëpi kur automjetet e rënda po përpiqeshin të kalonin. Të gjithë, fëmijët në rrugë, do të dilnim për të parë se çfarë po ndodh dhe do të shihnim furgonë ose kamionë, automjete të rënda dhe njerëzit përpiqeshin t'i nxjerrin jashtë.

Pasojat ishin të rënda. Sepse urat do të riparoheshin për ditë të tëra. Mbj mend të gjitha këto që nga fëmijëria. Ata vendosnin gurë të ngushtë në mes, po aq të gjerë sa këmba. Dhe ishte një sfidë për të kaluar. Një person mund të kalonte, tjetri jo. Ne fëmijët mbeteshim në anën tjetër. Unë shihja fëmijët duke luajtur, duke ecur në anën tjetër. Një ditë për të provuar veten time, për të fituar frikën time, desha ta provoja këtë. Nëna ime gjithmonë i përmend këto, ne qeshim. Rashë, pasi mora dy-tre hapa dhe rashë në tokë.

Ebru Süleyman: Në lum?

Sevim Baki: Rashë në lum, por lumi ishte i pistë, me gurë, ujërat e zeza kalonin andej. Megjithatë unë isha fëmijë, mbaj mend duke qarë e duke bërtitur, por frika ime më e madhe ishte, lumi nuk ishte shumë i thellë nganjëherë ngrihej, por herë të tjera ishte shumë i cekët, por ishte mjaft lum i pistë. Më kujtohet kisha shumë frikë sepse nëna ime gjithmonë na thoshte, “Mos shkoni shumë pranë tij, sirena do t'ju marrë, mos e shikoni nga afër!” Për të na penguar të binim, ajo po përpiqej të na mbronte disi, çfarë mund të bënte ajo, ne po luanim në rrugë si fëmijë. Dhe unë shkova tek nëna ime duke qarë, por ishte në rregull, ajo nuk më qortoi ose diçka. Thoshte, “Këto gjëra ndodhin, mos u shqetëso”. Siç thash shkollën e kishim shumë afër, shkonim-vinim, brenda ditës dy-tri herë nëse kishte nevoj madje edhe pantollonat shkonim i ndërronim.

Ebru Süleyman: Ju e keni vijuar mësimin në “Meto Bajraktari”. Atëherë në “Meto Bajraktari” kishte gjuhë turke.

Sevim Baki: Në “Meto Bajraktari” jemi arsimuar, po kishte gjuhë turke, poashtu turqisht mësohej në shkollën fillore që i thoshim “Vuk Karadžić” sot “Elena Gjika”. Nuk kishte shumë nxënës, ne për shembull shtatë-tetë veta kemi qenë në një klasë. Më kujtohet, më duket se më shumë vajza ka pasur, tre djem. Edhe në klasët tjera gjendja ishte e njëjtë por shumë... me shoqërinë ishim shumë të afërt. Dhe avantazhi më i madh, po them avantazh se për neve ka qenë e mërzitshme, por pasi që ishim pak mësimdhënësit na pyesnin çdo ditë, sepse nuk kishte shumë fëmijë. T’ju tregoj, për shembull lagja më parë ka qenë shumë e përzier, i përkisnin gjuhëve të ndryshme, thash që edhe ashtu emri i lagjes ishte “Vëllezërim Bashkim”.

Ebru Süleyman: “Vëllezërim Bashkimi” ku po i bie tani? Nëse e krahasojmë me sot ku ishte saktësisht?

Sevim Baki: Pikërisht te lumi {tregon me dorë} ku është ajo, si t’ju tregoj, Bahollarët janë, automekanikët janë aty, po i bie saktësisht pas “Meto Bajraktarit”, në vendin ku kalonte Prishtevka, e gjithë ajo rruga ishte rruga e “Vëllezërim Bashkimit”, deri atje poshtë.

Ebru Süleyman: Ku është tani ajo rruga e “UÇK”-së që po i thonë, aty ka qenë Divan Jolli, aty afër “Meto Bajraktarit”, duke shkuar në drejtim të Tophanës aty diku a?

Sevim Baki: Tophanja i bie pak më mbrapa por ajo rrugë e lidh Prishtevkën, një lagje mbrapa i bie Tophanja.

Ebru Süleyman: Në rregull, domethënë në atë pjesë ka qenë shtëpia.

Sevim Baki: Po edhe shumë shtëpi, tani u ndërtuan banesa, edhe ashtu babai im para 15 viteve ka dal prej aty u vendos në ndërtesat e reja këtu. Pse u zhvendos babai ajo është një arsye komplet tjetër, vëllau u shpërngul në Kanada, ne tri motrat tashmë ishim të martuara, shtëpia ishte shumë e madhe me oborr, ata kur u plakën deshën të jetojnë në banesë domethënë aty, ajo shtëpi u shit, fqinjët e morën. Shtëpia vonë ka qëndruar, nuk u prish fare, para saj u ndërtuan banesa por sa e di tani mbrapa saj pasi që është e planifikuar edhe aty u mbush me ndërtesa.

Tani plotësisht ndryshoi, nuk mbeti as shenjë nga ajo, balta u hoq, nuk ka lum, nuk ka ura, dyqane... nuk mund të them që janë hapur shumë dyqane por nën pronarët e atyre banesave u hap një dentist, një zdrukthtar që i themi ne, merret me makina, shesin tani më duket dyer dhe dritare, [nuk ka] aq shumë dyqane... automekanik ka domethënë, të gjithë janë njerëz që punojnë për vete, nuk është një vend që ka shumë, shumë dyqane qe jepen me qera. Ajo që dua të them është se që nga fëmijëria ime ne kemi folur tri gjuhë. Ndonjëherë mendoj se si e kam mësuar turqishten, serbishten, shqipen? E kam mësuar pa e kuptuar si, jemi rritur në tri gjuhë. Do të thotë kemi folur turqisht në shtëpi, turqisht në shkollë, por fqinji ynë i afërt ishte serb, fqinji ynë i tretë më kujtohet që ishin tri familje në të njëjtin oborr, ashkali, ata ishin shumë të përpiktë, njerëz të pastër që e flisnin gjuhën turke, si turqishten ashtu edhe shqipen, dhe kështu fqinjët e tjerë ishin shqiptarë. Në anën e djathtë ishin fqinjët shqiptarë.

Përveç kësaj, nën shtëpinë tonë sapo e kalon Meto Bajraktarin, fillon lagja rome. Ne nuk shkonim andej, afër shtëpive të tyre të rrënuara, rrugëve. Ishte disi si e ndaluar të shkosh në ato vende. Ne shkonim në shkollë dhe përdornim rrugë të tjera.

Ebru Süleyman: A është kjo pjesa që fillon nga “Meto Bajraktari” deri te hekurudha?

Sevim Baki: Po drejt rrugës së trenit, por në të gjithë lagjen. Sapo ju hyni në rrugën e “Meto Bajraktarit” duke kaluar atë lagje asaj rruge ishte lagja e romëve, e rrënuar. Tani do të habiteshit se nuk ka mbetur asnjë shenjë, të gjitha janë ndërtesa të reja. Ende sa herë që kalojmë atje kemi atë ndjenjë, “Nga po kalojmë!” Por ka disa ndërtesa të bukura, megjithëse nuk janë planifikuar mirë, por ato janë ndërtesa të larta në rrugën kryesore që lidhen me rrugën drejt Vushtrrisë, shumë automjete kalojnë nëpër atë rrugë tani.

Ebru Süleyman: Domethënë ashkalinjtë jetonin ndryshe prej romëve?

Sevim Baki: Romët ishin komplet ndryshe, fqinjët tonë ashkali ishin shumë të pastër, shumë të sjellshëm, të kulturuar, të respektueshëm, më kujtohet shumë mirë, nganjëherë nëna më dërgonte, “A po shkon ta marrësh një tepsi te tetoja Makbule?” apo ka mbetur pa diçka i nevojitet për bakllava, shkonim pa merak dhe e merrnim te ata.

Ebru Süleyman: Ata në çfarë gjuhe e vijonin shkollën?

Sevim Baki: Për besë ata shqip apo serbisht hiç nuk e di, nuk po më kujtohet. Ka qenë një Shenoll ai bashkë me motrën time shkonte në gjuhë turke, shumica kanë qenë në turqisht, njëri në Gjermani ka shkuar, atje i lindën fëmijët, më shumë flisnin shqip. Por një grua nga Gjakova që jetonte në shtëpinë e tretë, sepse në një oborr jetonin tre vëllezër, gruaja e njërit ishte nga Gjakova, sa mbrapa shkova tani të gjitha po më kujtohet ngadal, ngadal, ata i dërgonin shqip, shtëpia e parë që ishte ata turqisht flisnin edhe shtëpia e fundit turqisht por ata të gjithë fëmijët kanë shkuar në Gjermani, të moshuarit jetonin aty.

Ebru Süleyman: Në oborrin tuaj a ka qenë vetëm shtëpia juaj?

Sevim Baki: Vetëm ne por më herët kur e ka blerë babai me siguri edhe më herët kur e ka blerë gjyshi shtëpinë tonë, shtëpia e fqinjit serb ka qenë e ndarë vetëm me një tarabë, ne i thoshim tarabë, “i theve tarabat, mbroji tarabat, paska rënë taraba, mos e lag se prishet” prej drurit i bëmë ashtu rend, rend tarabat, asnjë problem nuk e kishim, kur zgjoheshim në mëngjes “*Dobro jutro!*” [serbisht - Mirëmëngjesi] ata neve na thoshin “*Günaydin!*” [turqisht - Mirëmëngjesi] (buzëqesh). Madje vajzat i kishin shumë më të mëdha se ne, kishin dëshirë të mësonin turqisht thoshin, “Ejani rrini me ne gjithë ditën ta mësojmë turqishten prej juve, edhe ju mësojeni serbishten prej neve”, madje xhaxhi Mille, ai plaku i moshuar gjithmonë turqisht fliste, dihej që atëherë më herët se të gjithë qytetarët e vjetër edhe serbët edhe shqiptarët gjithnjë e kanë ditur turqishten.

Për tu çuditur, serbi, të gjithë fëmijët i mësonin serbisht, e gjithë familja serbe, dhe prapë njeriu shumë bukur fliste serbisht, qetësisht, ata vinin tek ne për Bajram, ne shkonim te ata për festë. Thash që vetëm ajo tarabë na ndante neve, ishte një kapixhik¹, asnjë problem në jetë nuk e kemi pasur me ta, madje deri vonë, deri sa vdiq zonja e zotëriu jemi dëgjuar me ta përmes telefonit.

Ebru Süleyman: Më kujtohet edhe mua më ka treguar nëna, babai që edhe shqiptarët edhe serbët flisnin turqisht nejtë sikur ne domethënë nuk kishte fare ndryshim të gjithë flisnin. A ishte shumë më ndryshe turqishtja e shkollës me atë të shtëpisë?

Sevim Baki: Patjetër, patjetër, tani nuk e di pse babai ynë që ishte gazetar dhe shkrimtar mendohej shumë që neve të na e mësonte turqishten e vërtetë, thoshte për shembull... sjellte revista “Ayşegül”²

¹ Derë e vogël që i bashkonte oborret e dy shtëpive fqinje

² Me emrin original Martin, Ayşegül është versioni në Turqi i një serie librash për fëmijë. Ayşegül është një vajzë e vogël imagjinare dhe është krijuar nga autori Gilbert Delahaye dhe e vizatuar nga Marcel Marlier. Vendi origjinal i serive të librave është Belgjika dhe gjuha është frëngjisht. Secili vend ka një emër tjetër (Debbie në SHBA, Christina në Itali, Steffi në Gjermani, Emma në Angli, Anita në Portugali). Libri i parë i serisë (Martine Çiftlikte) u botua në frëngjisht në vitin 1954. Pas vdekjes së Gilbert Delahaye në 1997, aventurat e Ayşegül filluan të shkruhen nga djali i Marcel Marlier, Jean-Louis Marlier.

ka qenë shumë e bukur, prej Turqisë kolorite me siguri prej atyre që i njihte apo i porosiste dhe na sillte neve revista për fëmijë. Ngulte këmbë që të arsimoheshim, edhe pse nuk ishte shumë me neve pasi që gjithmonë punonte si gazetar, puna jashtë gjithmonë në rrugë, ai mendohej që të na arsimoj neve. Thoshte, “Ju lutem mësoni dhe kur të vi mi shpjegoni mua”.

E në shkollë mësimdhënësit për shembull edhe fëmijët nuk e di se si brenda sekondave e ndërronin, me siguri edhe ju e keni përjetuar këtu “Si je, a je mirë?”, mësuesja kur na thërriste menjëherë e flisnim turqishten standarde. Edhe diçka që është e rëndësishme unë për shembull vet kur shkruaj, por edhe në telefon nëse shkruaj nuk mund të shkruaj me një turqishte tjetër, vetëm me turqishten standarde shkruaj, atë e përdori domethënë dhe mendoj që ashtu duhet të jetë sepse në shkrim të gjithë jemi të njëjtë, njeriu edhe kur shkruan e shpreh veten më mirë me shkrim.

Këtë e kam gjithmonë në mendje domethënë kur shkruaj, edhe në telefon nëse shkruaj mesazh, apo email, ti nëse më dikton diçka unë në turqishten standarde do ta shkruaj, por të folurit mund ta ndryshoj përnjëherë. Përse është kjo kështu nuk e di, ndoshta ndikimi i nënës pasi që është nga Vushtrria ndryshe e fliste turqishten. E nëna na ka dhënë shumë përkrahje që të flasim turqisht, të mësojmë turqisht për çdo gjë na ka dhënë përkrahje nëna, por turqishtja e saj ka qenë turqishte e Vushtrrisë.

Ebru Süleyman: A ka shumë dallim turqishtja e Vushtrrisë me turqishten e Prishtinës?

Sevim Baki: Për besë unë shumë nuk e kam vërejtur por kur u martova qeshnin me mua familja e bashkëshortit, vjehrra, vjehri thoshin, “Ti po flet më ndryshe, pak më rëndë!”, disi më vinte inat, bashkëshortin e kam të Prishtinës, nënën e ka të Prishtinës, edhe babai është i Prishtinës, babanë e ka Birvenik nënën Ömer, ata [flisnin] pak më... ku ta di, ashtu si duhet të jetë gjuha prishtinase. Pastaj ata kur qeshnin unë fillova ta vërej dallimin, sepse me siguri për shkak të familjeve, shkonim shumë te tezet, dajët edhe ata flisnin më rëndë. Edhe hallën e kam në Vushtrri, por halla me siguri që ka shkuar prej këtu ajo nuk e ka ndryshuar [të folurit]. Për shembull shumica mua nuk më thonë Sevim por Sevim më thonë, nuk e kuptoj pse, thashë, “Aq vështirë qenka të thuash Sevim?”, për shembull...

Janë ato dallimet, janë, siç e dini thekset në Kosovë, nuk po them dialektet sepse dialektet kanë më shumë ndryshime, por këto janë ndryshime të vogla në gjuhë, vetëm te fjalët dhe intonacioni i zërit që ndryshon, ndryshe i përdorim ato, prandaj me Prizrenin ka ndryshim të madh, ka ndikuar shqipja, serbishtja, turqishtja që është folur në një vend. Në Vushtrri siç thash pak më rëndë, madje vonë e kam vërejtur që edhe në Mitrovicë shtojnë disa prapashtesa “*tiga na, ettim ga, ettim ga*” [Ja ku e ke, e bëra, e bëra] kam dëgjuar prej shoqeve. E Gjilani, sipas meje në Gjilan shumë pastër flasin, sikur ne por edhe ata mundohen, i kanë, i kanë disa tone të zërit ndryshe. Edhe në Prishtinë nuk e di, varet prej familjes, ndoshta çfarë ndikimi ka pasur në familje, edhe babai bën diçka për fëmijët, edhe familja ka shumë ndikim po të flasin në turqishten standarde, por jo edhe sot me turqishten tonë flasin, ndërsa me mësuesen dhe gjatë mësimin e flasin turqishten standarde.

Në fakt unë kur isha në universitet, në Degën e Orientalistikës, shumë profesor që vinin nga Turqia thoshin, “Turqishtja në rregull, por neve po na pëlqen kjo turqishtja e juaj, ruajeni, edhe neve na nevojiten këto të folura”. Domethënë gjithkund ku ka gjuhë turke ata i mblidhnin, i përpilonin dhe e

bënin pjesë të degës, në të gjitha vendet ku, sado gjuhë që kishte ata i analizonin të gjitha. Ne mburreshim, dhe bënim shaka me shoqet, ju thosha, “Nuk ka nevoj të flasim me turqishten standarde, kemi marrë konfirmim se mund të flasim gjuhën tonë”.

Ebru Süleyman: Përveç kësaj unë mendoj se ka një efekt për ta ruajtur atë vetëm me gojë, turqishtja që ne e përdorim këtu nuk u standardizua kurrë, kështu që shkrimi dhe leximi me turqishten standarde është më i lehtë, mendoj.

Sevim Baki: Sa i përket të folurit, tham që më herët më ndryshe ka qenë, më shumë familje flisnin turqisht, tani edhe në vendin e punës, pasi që punoj në ministri, e dini që qe 20 vite pas luftës shumë ka që janë shpërngulur, të mos them njerëzit kanë ikur nga fshati. Të gjithë këtu janë shkolluar por as që e dijnë për ekzistencën e turqve. Pastaj unë gjithmonë kur flas për qytetarët, thojnë, “Çka? Unë kurr s’kam dëgjuar, a paska turq këtu?” domethënë ka të tillë. As të rinjtë nuk e dijnë sepse në ato vende turqit fare nuk kanë jetuar sepse turqit kanë qenë gjithmonë nëpër qendra, prandaj nuk dijnë as për ekzistencën e turqve.

Ebru Süleyman: Kur keni filluar të merreni me muzikë dhe me art? A kishte ndonjë lidhje me fëmijërinë? Na tregoni pak çfarë fëmije keni qenë, nga njëra anë e tërhequr dhe e urtë por siç duket e keni pasur edhe një anë të artistes?

Sevim Baki: Po, shumë e ndrojtur kam qenë, nuk flisja shumë, nganjëherë them me siguri pasi që i kisha dy motra më të mëdha, nuk më është dhënë liria e shprehjes por nuk është ashtu sepse kurrë nuk kemi pasur probleme ndërmjet vete, “Kjo është më e madhe, le të flet!” një shkelje të tillë as nëna nuk e ka bërë. Gjithmonë kemi pasur të drejta por më kujtohet që në çdo vend isha e ndrojtur. Dikush nëse më pyeste diçka më vinte turp me siguri secili e përjeton këtë si fëmijë. Prej kur di për veten unë jam rritur dhe jam mësuar me muzikë.

Si ka ndodhur, tani saktë nuk e di, babai shpesh më tregonte që e ka pasur një dajë, dajën Şerif në lagjen Katër Llullat. Edhe nëna tregonte që ata në shtëpi rrinin me defa dhe darabuke, gjithmonë me këngë, bënin ndeja, vinin vajzat e martuara te nënat, vraponin halla e teze vinin, por gjithmonë me defa, darabuka, më thoshte se, “Daja shumë këndonte”. Ndoshta si fëmijë kjo na ka lënë përshtypje dhe na kanë mbetur në vesh.

Më kujtohet që nëna dhe babai na merrnin me vete në çdo koncert që është bërë e që është organizuar këtu. Në çdo vend na merrnin. Nëse kanë ardhur nga Prizreni, apo kanë ardhur nga Shkupi teatrot apo shoqatat... madje kur ka ardhur edhe Emel Sayın³ kemi fotografi prej skenës, si jemi ulur dhe e kemi dëgjuar. Më kujtohen, shumë mirë më kujtohen ato skena domethënë në çdo vend që kishte diçka turke ne merrnim pjesë. Edhe ashtu babai ishte themelues i gazetës “Tan”⁴, ka qenë një person që ka dhënë kontribut në themelimin edhe të radios, edhe për gazetari dhe për çkado që kishte këtu. Në mbajtjen gjallë dhe promovimin... Prandaj çkado që ndodhte ne si familje e parë ishin në çdo vend. Me siguri edhe kjo ka ndikuar, por motrat tjera nuk janë ashtu.

³ Emel Sayın (1945) Këngëtare dhe aktore e famshme turke

⁴ Gazeta e parë në gjuhën turke në Kosovë që për herë të parë u botua më 1 maj 1969 dhe u mbyll në vitin 1992

Kur isha shumë e re, ishte një këngë e Emel Sayın, *Sevda sevmessen* [Kur nuk dashuron, dashuro]... quhej *Rüzgar* [Era], isha shumë e re dhe e imitoja shpesh. Kur kusherinjtë e mi vinin, thoja, “Dëshironi t’a imitohet Emel Sayın?” Ulesha, vëja jastëkët në tokë, flokët në një anë {tregon me duar}, thoja, “Merreni tharësen e flokëve që flokët e mija të dukeshin sikur po i fryn era si asaj në video”. Ata më duartrokisnin. Kur vinte ndonjë musafir, babai im thoshte, “Hajde, këndo disa këngë”. Tani, kur e mendoj, mund të them që ka pasur shenja që do të kem lidhje me muzikën.

Por çka ka mundur të jetë ndikimi më i madh, sa ishim shumë të vegjël babai të katër fëmijëve na dërgonte në shoqatën kulturore-artistike “*Gerçek*” [E Vërteta]. “Shkoni bëhuni aktiv!”. Edhe ashtu të gjithë fëmijët turk kanë qenë në shoqatën “*Gerçek*”. Të gjithë ishim aktiv, në folklor, fillova me folklor pastaj ndërkohë fillova edhe të këndoja, kishte të rinj me kitarë, murmurisja nga pak ashtu, “Hajde, hajde Sevim lëshoje zërin! Edhe ashtu je artiste, hajde ti ke vesh të bukur” kështu më inkurajonin. Gjithmonë shkonim në rreshtin e fundit të autobusit, të rinjtë me kitare, unë këndoja.

Pastaj në atë periudhë ishte grupi “Faks” me të rinjtë, pak muzikë të lehtë turke. Në shoqatën kulturore-artistike “*Gerçek*” të Prishtinës, grupi i parë kështu modern ishte grupi “Faks”, edhe ata më thoshin, “A po vjen Sevim, po punojmë në ‘*Gerçek*’ po e formojmë një grup?” dhe kështu fillova. Pastaj njëri prej tyre shkoi në ushtri, në mesin e tyre ishte edhe bashkëshorti im, ai ishte ushtar dhe as që e njihja, pasi erdhi thanë, “Është një [djalë] që i bie shumë mirë sazit⁵ dhe udit⁶”. Në rregull, filluam të këndonim, në atë kohë xhaxhi Rasim bënte koncerte në “*Gerçek*”, por në të njejtën kohë xhaxhi Rasim me orkestër merrte pjesë në mënyrë që të kishim përkrahje. Shumë i pëlqeu.

Ebru Süleyman: Rasim Salih në atë kohë në radio bënte muzikë...

Sevim Baki: Në radio, për herë të parë prej ‘51-tës qëkur janë themeluar të gjitha këto institucionet, radioja, gazetaria, televizioni, në pjesën e dytë formohet edhe orkestri turk, orkestri profesional, në atë kohë xhaxhi Rasim i mbledhte të rinjtë, kush i dukej më i aftë, i inkurajonte, edhe bashkëshortin tim në atë kohë e ka marr aty. Bashkëshorti im në të njejtën kohë aktivitetet e para në “*Gerçek*”...

Ebru Süleyman: “*Gerçek*” në atë kohë ku gjendej?

Sevim Baki: Në të njejtin vend ku është sot. Jo! Në atë kohë... gabim... Në atë kohë si t’ju shpjegoj, kjo rruga e qendrës, në fund të kësaj rruge shkon, ka qenë një bibliotekë dhe para saj një rrugë, jo rruga e Bylykbashëve, jo rrugica e shtëpisë së Bylykbashëve, rrugica tjetër, por në atë rrugicë ka qenë një xhaxha turk, xhaxhi Regjep, ai e hapte dhe e mbyllte atë kopshtin.

Ebru Süleyman: Nga ana e komunës apo këndeje nga Divan Jolli?

Sevim Baki: Kah Divan Jolli, menjëherë te ky tuneli i madh që është tani, nënkalimet që janë përfundi banesave, në anën e djathtë të tyre, afër klubit të boksit, por hyrja ishte nga pjesa e qendrës aty

⁵ Sazja (*Saze*) ose Bakllama është një instrument muzikor me akordim që është përdorur në muzikën klasike osmane, popullore turke, perse, azere, asiriane, armene, nëpër Siri, Irak dhe Ballkan.

⁶ Instrument me prerje e qafë të shkurtër, në formë dardhe, me 11 ose 13 tela të grupuar në 5 ose 6 kurse.

shkonim. Sipas meje periudha më e bukur, më aktive, periudha më e suksesshme ka qenë kjo periudh, kur ishim të ri menxi prisnim të shkonim.

Ebru Süleyman: Sa vjeçare ishit?

Sevim Baki: 14 vjeçare kam qenë, ne tri motrat e filluam folklorin, madje Suna pak më vonë u bashkangjit.

Ebru Süleyman: Përveç folklorit dhe muzikës çfarë aktivitete të tjera bëheshin në “Gerçek”?

Sevim Baki: Në atë kohë kishte shumë aktivitete, në atë kohë ka filluar apo disa vite më vonë nuk më kujtohet, por provat i mbanim në teatër. Mbaheshin në teatër, madje motra ime ka luajtur pak në teatër pastaj ka mbetur në folklor. Duke marr pjesë në folklor dhe kështu ndërkohë duke kënduar ia pëlqyen zërin, ishte një koncert në Kaçanik ‘86-tën, më thanë, “Jo Sevim, edhe ti dil! Çka të këndojmë?”, “*Size Selam* [Përshendetje për juve] dhe *Karanfil Bestesi* [Kënga e karanfilit]” atëherë i donim këto këngë popullore. Dola, falemnderit prej xhaxhit Şükrü, Zeynullah, kisha shumë emocione, ai më qëndroi pranë, “Sevimcim mos u frikëso fare, sikur nuk është askush, ti drejt shiko, mos e shiko askënd në sy këndeje {tregon me dorë} në pjesën e fundit të kokës dhe këndoje këngën, mos u shqetëso fare do të del bukur!”. Madje me veshjen e folklorit edhe vallëzova edhe dola për të kënduar.

Pastaj filluam në radio, në radio deri të ‘90-tën afër ‘80-tës inçizonim këngë, këngë artistike turke dhe këngë të lehta turke. Pastaj kam qenë shumë aktive sapo i mbusha 18 vjet, shkolla e mesme mua menjëherë... Para kësaj prizrenasja Nesret Jakupoviq ishte gruaja e parë përgjegjëse për radion turke në Prishtinë. Ajo u kujdes shumë për mua, “Sevim të lutem regjistroje shkollën e muzikës, shkollën e mesme të muzikës, ti ke shumë talent, a e merr si instrument çellon, apo zërin e ushtron, të lutem orkestri ka nevoj për ty.” Edhe atëherë bashkëshorti ishte i ri, tha, “Ne edhe ashtu në një grup kemi punuar” tha, “Sevim shiko, interesohu mos shko në shkollë normale, regjistrohu aty [në shkollë të muzikës] e ke më sigurt”.

E fitova një nxitje dhe me një këngë filloi gjithçka, me folklor këndoja ndonjë këngë andej-këndeje. Pastaj hyra në shkollën e mesme të muzikës, shkova të regjistrohem. Me atë njeriun po flisja shqip por serbisht deshta të regjistrohem. Pse? Ne kishim shumë miq dhe fqinjë serbë siç ju thash, madje edhe në shkollë e kishim nga një orë të serbishtes si gjuhë vendore.

Ebru Süleyman: A është ajo shkolla e muzikës përball “Elena Gjickës”?

Sevim Baki: Atëherë ka qenë “Stevan Mokranjac”, shkova të regjistrohem, ai njeriu po më thotë, “Ti mjaft mirë po flet shqip, këta e kanë kuotën e plotësuar por t’i nëse do mund të të pranojmë në shqip”. Sepse serbët për shembull shpejt i plotësonin numrat, nuk pranonin shumë fëmijë dhe unë thash si më kujtohet, “Nuk ka rëndësi fare, unë as serbishten as shqipen nuk e di, unë jam turke”, “Në rregull” tha, “Po të regjistrojmë në shqip sepse aty ka vend, nuk është mbushur kuota”.

Hyra, mësova katër vite, fillova me çello por kishte mungesë të kuadros, mësuesi im vinte nga Maqedonia, pas 6 muajve ai nuk mund të vinte më, u sëmure, ishte njeri në moshë, mbeta, çfarë të bëj, për zërin... i përfundova katër vite në departamentin e konservatorit, pak pianos i bija. Ajo periudhë

siç thash ishte edhe periudha më aktive edhe e përfundova shkollën e mesme në një gjuhë të re. Nuk e di sa ju kujtohet, kanë qenë “Akordet e Kosovës”, festivale të rëndësishme, në Prizren “Zambaku i Prizrenit”, ku unë e mora çmimin më të madh për pjesëmarrje... Madje Barış Manço⁷ ka qenë atëherë mysafir nga Turqia, e sollën, dhe atë vit unë e fitova si një turke çmimin e publikut. Në “Akorde” gjithnjë e merrja vendin e dytë, mikrofonin i artë, më shumë më shpërblyen me çmime mikrofonin i argjendtë. Kompozimet, gjithmonë i këndoja kompozimet vendore, kompozimet e Şemsi Mecihanit, me xhaxhin Şemsi shumë kemi bashkëpunuar, ka qenë njeri i mirë, kompozitor i mirë. Falë tij, me pesë-gjashtë këngë të tij gjithmonë kam fituar. Dhe kështu domethënë.

Pjesa e Dytë

Ebru Süleyman: Këto gjërat që i përmendët a kanë qenë festivale?

Sevim Baki: “Akordet e Kosovës” ka qenë festival, e “Zambaku i Prizrenit” është bërë një herë në vit, ende mbahet, pasi që Prizreni njihet si një vend kulturor, pasi që ka lum, aty bëhet çdo vit “Zambaku i Prizrenit”. Por “Akordet e Kosovës” ishin në tri gjuhë, dhe gjithmonë organizohej nga ana e radios, radios profesionale të Prishtinës dhe patjetër është dashur një apo dy këngë serbe dhe një apo dy këngë turke. Unë natën e dytë këndoja këngë të lehta, nganjëherë këndoja natën e parë të mos them muzikë artistike por muzikë pak më moderne turke. Natën e parë kanë qenë më komplekse kështu artistike, të dytën muzikë më e lehtë, por në të dyja rastet i këndoja kompozimet e xhaxhit Şemsi.

Më kujtohet që më ka ardhur oferta nga dy herë prej Tomor Berishës, “A po vjen të këndosh shqip”, më ka lutur, “Eja, ndryshoje pak zhanrin, këndo edhe shqip, shumë po të dojnë, shumë je e famshme.” Por nuk kam pranuar edhe ashtu turqit nuk kishin ndonjë artist, prandaj s’kam pranuar përndryshe ndoshta do të shkoja po t’i mendoja fitimet nga ana financiare. Por “Jo” thosha, “Ju keni mjaft artistë unë po të zhvendosesha aty, ku mbeti turqizmi im?” dhe nuk kam shkuar.

Ebru Süleyman: A u bë në Prishtinë ky festival?

Sevim Baki: Po gjithmonë, sepse qendra ku ishte radio, pasi që ishte kryeqytet, pasi që radioja ishte këtu gjithmonë në “Sallën e Kuqe” mbahej, mundoheshin t’i zbukuronin ato salla që të kenë pamje më të mirë, edhe ashtu ishin tepihët e kuq por edhe më shumë zbukurohej, gjithçka shkonte drejtëpërdrejtë nga ana e televizioneve domethënë ka qenë një festival shumë i bukur, i vlefshëm.

Ebru Süleyman: Në atë kohë kjo salla domethënë “Salla e Kuqe” në “Boro Ramiz” ka qenë shumë e popullarizuar apo jo?

Sevim Baki: Ishte e popullarizuar dhe mbushej përplot, më kujtohet, kam edhe fotografi por pasi që kishte shumë kuadro, shumë artistë mundoheshin tepër për të hyrë në festivalin “Akordet”. Unë e kisha shansin pa u munduar fare, më kanë ftuar dhe e para hyja. Pastaj e bëra një shoqe Violeta

⁷ Barış Manço (1943-1999) Këngëtar turk i muzikës rock, tekstshkrues, kompozitor, aktor dhe producent i famshëm televiziv.

Rexhepagiq, motra e Armend Rexhepagiqit, bënte muzikë shumë moderne, dëshironte të merrte pjesë në garën për “Eurovision” në Beograd.

Dhe e zgjodhi një serbe Ivana Vitalliq, mua Sevim Baki dhe veten, e bëri një këngë, grupit ia lamë emrin “Vivien”, në fakt ajo ia vuri dhe organizoi gjithçka. “Sevim” tha “Do të doja të vije, ne të trija, serbisht, shqip ta këndojmë një këngë dhe të marrim pjesë në ‘Eurovision’” dhe ne ‘86 - ‘87-tën morëm pjesë në festivalin e “Eurovisionit” në Beograd. Edhe pse nuk fituam diçka na mbeti, të paktën morëm pjesë.

Ebru Süleyman: Çfarë përvoj ishte kjo, kur shkuat atje, a mund të më tregoni pak?

Sevim Baki: E mrekullueshme, sepse unë komplet ndryshova ajo të gjithëve na bëri të ngajmë si ajo. Ma bëri një stil të flokëve mua {tregon me duar} me ngjyrë vjollce ajo ishte shumë kështu, nuk e di sa e njihni, ka qenë grua me një stil hipik. Fustanet secila sipas stilit të saj i veshnim por u mundova të përshtatem, njëra dorashkë më e gjatë, tjetra më e shkurtër, kështu u munduam të bëjmë diçka me stil hipik. Ka qenë mirë të jesh në një ambient krejtësisht tjetër.

Ebru Süleyman: A ishte hera e parë që keni bërë diçka të tillë bashkarisht?

Sevim Baki: Po, hera e parë që kështu në tri gjuhë kënduam, hera e parë ka qenë por unë kam marr pjesë në shumë vende sepse Kosova ka organizuar shumë turne, shqiptarët organizonin. Dikush kishte marr përsipër që nëpër gjithë Kosovën brenda 15 ditëve të organizoheshin turnetë, por ato turne ishin ligjore, patjetër duhej të ishin në tri gjuhë.

Nëse në koncert ishin pesë-gjashtë këngëtarë shqiptarë, patjetër duhej të ishte një serb dhe turk. Tani po e shihni si është secili për vete, nëse ke sponzor, nëse ke përkrahje apo nëse të ndihmon dëgjuesi sado pak, aq punë bën. Për shembull në “RTK” kanë filluar të mos e emitojnë asnjë program muzikor në gjuhën turke, kurse më herët patjetër ka qenë nëse dikush bënte program aty duhej të ishin edhe njerëzit si përfaqësues të gjuhëve tjera. Tani për shembull jo. Hapni kanalën dëgjoni vetëm shqip, apo në “RTK 2” vetëm serbisht dëgjoni, në gjuhën turke vetëm lajmet kanë mbetur, përveç asaj edhe një program “Mozaiku” nëse ka mbetur, por unë këto vite të fundit asnjëherë nuk kam marr pjesë në ato programe. Çka e ka shkaktuar këtë nuk e di, por shumë diçka nuk po punojnë që të më thërrasin mua apo dikë tjetër, tani po thonë edhe buxhet nuk ka shpesh, apo nuk ka përkrahje, ku është çështja unë nuk e di por ka shumë ndryshim.

Ebru Süleyman: Domethënë ka një ndryshim të madh sa i përket aktivitetit dhe përfaqësimit?

Sevim Baki: Shumë, shumë, sa i përket përfaqësimit thash që në çdo vend ka qenë, “vëllazërim bashkimi, vëllazërim bashkimi...” Nëse në televizion apo në radio inçizohet një program prej institucioneve të shtetit, nëse organizohet atëherë... unë gjithmonë them aq e zënë kam qenë atëherë, më thoshin, “Patjetër duhet të ketë turqisht, në të duam ty, ti eja me neve” dhe unë bashkangjitesha në turne.

Paguhej diçka për shembull nëse ka qenë rruga e gjatë, sepse nganjëherë i jepnim nga dy koncerte, për shembull një fshat një qytet, një fshat një qytet... Nëse shkonim në Gjakovë, edhe në Klinë

performonim, pastaj prej Gjakovës nëse shkonim në Prizren asaj radhe në Suharek e jepnim një koncert në [ora] 4, 7. Këto fare nuk mbaronin, sallat ishin përplot, nuk mund ta mohoj që sa herë dilja unë ndizej audienca, ato kurrë s'mund t'i harroj madje më vjen keq sepse nuk kam video inçizime, mund të mbeteshin si kujtim, edhe pse janë disa foto prej personave që kanë organizuar por ato nuk i kam në dorë.

Ebru Süleyman: Cilat vite kanë qenë këto?

Sevim Baki: Të gjitha prej '86-tës, '87, deri '88-tën. Pastaj përfundoi shkolla, u martova, u punësova. fillova të punoj në radio si person përgjegjës për muzikë për programet turke, programet arkivore. Përveç të qenit përgjegjëse për muzikën, unë gjithashtu udhëheqja, organizoja programe me artistë. Në të njëjtën kohë, shkoja në katin e poshtëm në ndërtesën e radios, duke rregulluar orarin, për shembull, gjatë një jave, do të punonim me orkestrën dhe do të regjistronim shfaqje të reja. Por dihej se programi i Vitit të Ri për muajin dhjetor duhej të inçizohej një muaj më parë, kjo ishte e pashmangshme, gjithmonë duhej të kishte pjesë të reja, kështu që ne fillonim të punonim në muajin e nëntë, shtator, që të ishim gati për inçizimet. Dhe tani, edhe pse kemi një televizion, një radio, ne nuk kemi më gjurmë të këtyre programeve.

Ebru Süleyman: Nëse mund të flasim pak për stilin e muzikës, ju e përmendët muzikën klasike turke, e përmendët muzikën e lehtë turke, muzikën moderne, a mund t'ju shpjegoni njerëzve cili është dallimi ndërmjet këtyre stileve, nëse dëshironi mundeni edhe anën teknike ta shpjegoni, si të doni?

Sevim Baki: Muzika klasike turke është një muzikë shumë autoritative, muzikën klasike turke ndoshta gjithkush nuk mund ta këndo, mund të murmurisni, ta doni, mund të jeni dëgjues shumë i mirë por gjithkush nuk mund të këndo. Nëse shikoni më herët, kjo ka filluar si muzikë shumë e rëndë klasike, domethënë është një muzikë që ka filluar me hyrjen e Perandorisë Osmane në Ballkan, jo, ajo është lidhur me këngët e Rumelisë⁸, {mohon me dorë} më fal se gabova, ajo është lidhur me këngët popullore të Rumelisë. Dëshja ta bëj një krahasim ndërmjet muzikës klasike turke dhe muzikës tonë popullore të Rumelisë. Ju nuk mund ta përdorni çdo instrument në muzikën klasike turke, madje edhe pse u ndikua nga Perëndimi, evoluoi me aranzhime dhe sende të ndryshme muzikore. Gjithashtu, mbaj mend xhaxhi Rasim, na bëri ta praktikojmë shumë atë.

Në muzikën artistike turke ka qenë Muazzez Abacı⁹, Zeki Müren¹⁰, Ahmet Özhan¹¹, Zekai Tuncayın¹² e dëgjonim, më thoshte, “Dëgjoje Hamiyet Yüceses¹³ bijë, pastaj merre prej saj një bagazh”... Madje edhe tani dëgjoj shumë programe të ndryshme, domethënë i dëgjoj, i di ato-këto, kam shumë bagazh

⁸ Rumelia ishte hapësira e Ballkanit të cilën popujt e vjetër e konsideronin si toka të popullsisë së romanizuar për nga mënyra e jetesës e që dallonte nga mënyra e jetesës në Anatoli.

⁹ Muazzez Abacı (1947) Këngëtare e muzikës klasike turke. Ajo është aktive që nga viti 1973

¹⁰ Zeki Müren (1931-1996) ishte një këngëtar, kompozitor, aktor dhe poet turk.

¹¹ Ahmet Özhan (1950) është një këngëtar, dirigjent dhe aktor i shquar i muzikës klasike turke. Ai filloi të këndoje në klubet turke kur ishte rreth 18 vjeç. Ai kreu koncerte në të gjithë Evropën, Sh.B.A dhe Lindjen e Mesme me grupin e tij.

¹² Zekai Tunca (1944) është një këngëtar i muzikës klasike turke. Në vitin 1998, ai mori titullin Artist i Shtetit dhënë nga Ministria e Kulturës dhe akoma punon si solist në Ministrinë e Kulturës.

¹³ Hamiyet Yüceses (1916-1996), artiste e muzikës klasike turke

sepse në atë kohë kam dëgjuar shumë kasete, kam punuar shumë. Edhe në “Gerçek” edhe në radio, domethënë në atë kohë me moshën që e kam pasur e kam formuar një repertor mjaft të madh.

Jam e kënaqur me këtë sepse mendoj që nuk ka këngë turke që nuk e di, nganjëherë del diçka them si nuk e paskam dëgjuar këtë, ndodh edhe ajo sepse ka shumë këngë, siç thash violina, udi, daullja, është një muzikë e rëndë që realizohet me këto intrumente. Nga ana tjetër, muzika popullore Rumeliane, të cilën ne e kemi përdorur shumë për të kënduar sepse është lokale, ajo ka filluar kur Perandoria Osmane arriti në Ballkan dhe u ndikua prej tyre. Ka dallime sepse çdo rajon dhe gjuhë ka shkrimet, meloditë dhe instrumentet e veta.

Ebru Süleyman: Domethënë muzika e Rumelisë më shumë buron prej popullit. Muzika klasike turke më shumë është e bazuar në edukim?

Sevim Baki: Bazohet në edukim sepse çdo këngë ka sistemin e vet të llojeve të melodisë dhe meloditë janë vërtet të rëndësishme, por për fat të keq nuk pata mundësi ta gjej dikë këtu që do të më mësonte këto melodi.

Bashkëshorti im i din shumë mirë, por përse i din, sepse ai i bie instrumenteve ka punuar me ato shkallët dhe ambituset, ai ka më shumë prirje. Unë pasi që e kam ushtruar më shumë zërin nuk i kam ditur mjaft mirë notat. Më siguri pasi që gjithmonë me vesh kemi ushtruar, “Hajde këndoje një këngë, hajde diçka...”, por po të merrja edukim të denjë muzikor patjetër do t’i mësoja edhe notat sepse janë shumë të rëndësishme. Është e turpshme po ta takoja ndonjë turk dhe po të më pyeste, është e turpshme por fatkeqësisht nuk ka pasur kush të më mësoj.

Ebru Süleyman: Rasim Salih, ku ishte interesuar për muzikë, ku i kishte mësuar këto gjëra?

Sevim Baki: Lidhur me këtë nuk di shumë por sipas një programi që e kanë punuar nipat e tij, siç e pash ai ishte njëri prej artistëve të parë në Mitrovicë, dhe ai ka kontribuar shumë, ka themeluar, ka vënë në punë, i ka mbledhur njerëzit, i ka ushtruar. Me vesh i kishte gjetur muzikantët, edhe xhaxhi Rasim shumë vonë ka filluar t’i mësoj notat, këtë më ka treguar bashkëshorti, por e ka pasur shumë të fuqishme pasurinë muzikore falë veshit.

Ebru Süleyman: Jam kurioze për muzikën e Rumelisë, të cilën mendoj se e bartin njerëz që migrojnë nga një fjalë në tjetrën, nga një familje në tjetrën dhe nga një brez në tjetrin. Por muzika klasike turke bazohet në edukim, pra si dhe kur u formua në Ballkan?

Sevim Baki: Jo, mendoj se dëgjojmë muzikë turke sepse ne e shohim Turqinë si atdheun tonë. Mbaj mend që e kemi njohur çdo artist turk këtu, kemi qenë shumë të afërt edhe kur blenim. Më kujtohet të gjitha dollapat i kishim me kasetofon, i blenim kasetat jo sikur tani me CD apo gjëra të tjera, dollapat ishin të mbushur me kasete. Sepse kur shkonim në Turqi unë nuk ngopesha dot, 20 - 30 [kasete] i bleja. E ato kanë vlerë të çmuar, sikur ti kisha ruajtur. Edhe ashtu i shpërndanim, “Ti e ke ma jep këtë javë ta dëgjoj këtë, ma jep atë”, kanë mbetur diku janë prishur. I mbledh, i hedh. Kështu që fatkeqësisht nuk ka mbetur gjë prej tyre.

Me siguri kështu ka qenë sepse marrëdhënjet ndërmjet Kosovës dhe Turqisë kanë qenë gjithmonë të mira, për këtë arsye ne edhe televizionin e kemi ndjekur, edhe shkonim-vinim. Më herët ka pasur më shumë lidhje, shumë shpesh shkonim ne. Me të vërtetë telefonat, internet nuk kemi pasur, por më kujtohet familja gjyshes, pastaj kur u rritëm në shumë festivale kemi marr pjesë me shoqatën “Gerçek” në Çorum, Silifke, Iskenderun, Kastamonu.

Ebru Süleyman: Në vitet e ‘80-ta kush ka qenë më aktiv në “Gerçek”, domethënë kush mësonte teatër, folklor apo muzikë, kush organizonte më shumë?

Sevim Baki: Për teatër nuk më kujtohet tani sepse shumë janë ndërruar, kush ka qenë... e di që ka qenë Ercan Kasap, teto Aliye, babai pak ka luajtur, motra Senay ka luajtur. Por kush e ka menaxhuar fare nuk po më kujtohet, hiç se kam në mendje.

Me folklor janë marrë folkloristët e vjetër në kohën time njëfarë Kemal, Kemo i thoshim, këtu ka ardhur si student pastaj e kishte provuar “Gerçek”, ka qenë student i ri por e ka njohur folklorin shumë mirë. Edhe ashtu e dini që në Turqi secili nxënës ose sazin e di, ose është i lidhur me kor në shkollën e tij, apo luan në ndonjë folklor, mua më ka fascionuar kjo sepse kjo është shumë e rëndësishme dhe duhet nëpër shkolla t’ua promovojnë këtë fëmijëve. Ata i inkurajojnë fëmijët në një mënyrë dhe i drejtojnë ata drejt kulturës dhe aktivitetit. Ai djalë ka ardhur këtu nuk dinte se si ta kalonte kohën dhe na mësoi neve folklorin, dhe në atë periudhë ne filluam t’i mësonim lojërat popullore turke pak më moderne, *çerpikli*¹⁴, *halaylar*¹⁵, këto lojërat popullore turke filluam t’i mësonim prej aty.

Ebru Süleyman: Na treguat për periudhën në “Gerçek”, më pas për shkollën e muzikës, regjistrimet në radio dhe përgatitjet e Vitit të Ri, pra a filluat ju prapë të punoni në radio në vitet ‘80, ‘90?

Sevim Baki: Në vitet e ‘90-ta sapo e përfundova shkollën, menjëherë erdhi oferta, “Sevim sapo ta përfundosh shkollën neve na nevojitet një përgjegjës për muzikë, na nevojitesh këtu, nëse do edhe si artiste...” por aty nuk ishte një vend pune, më shumë si hobi, shkoja i bëja inçizimet, por gjithçka që bëhej turqisht në emër të shtetit në radio më thërrisnin mua .

Një kohë kam hyrë në korin klasik profesional, diku tre muaj, i mësova dhe i doja notat, këngët e operave me nota i kam mësuar diku tre muaj dhe isha shumë e interesuar të punoj aty por nuk u bë. Unë universitetin nuk e përfundova sepse menjëherë pas shkollës së mesme u punësova, u martova, shpërtheu lufta, nëntë vite punova si përgjegjëse për muzikë. Por në vitin e tretë e lash në gjysmë universitetin dhe nuk e vazhdova, me siguri fëmijët, u lehtësuam, çdo gjë ishte e bukur, punë kishim, shtëpi, fëmijë, shumë aktivitete nuk kisha, domethënë nuk ka qenë një periudhë e ngjeshur.

Fillova edhe “Gerçek”-un ta lë pak anash. Vinin gjeneratat e reja, shkoja vetëm si artiste për inçizimet në televizion apo në ndonjë koncert. E kam pasur një periudhë hezituese, siç thash u bënë fëmijët, pastaj lufta ndërhyri dhe ne mbetëm pa punë.

¹⁴ Vallëzim popullor me ritëm të shpejtë nga rajoni i Gaziantepit

¹⁵ Stilet e vallëzimit popullor në Anadollin qendror dhe juglindor

Por kjo nuk zgjati shumë sepse babai ishte mjaft aktiv dhe unë duke kërkuar andej-këndeje neve gjithkush na njihte, një radio me kontakt të veçantë, radio me kontakt multietnik, me serbë, boshnjakë, turq, shqiptarë, romë, programe të lajmeve dhe programet muzikore filluan dhe neve aty na morën. Babai punonte te lajmet pastaj edhe mua më mori si përgjegjëse për muzikë, i mora edhe mjaft shokë turk aty, kemi punuar diku 18 muaj pastaj edhe ajo u mbyll, unë prapë mbeta pa punë.

Ebru Süleyman: Domethënë menjëherë pas luftës?

Sevim Baki: Menjëherë, menjëherë, pas nëntë viteve pune, nuk kishte më as orkestër, as artistët nuk u kthyen, as ajo gazetaria jonë nuk u zhvillua, ato programet e lajmeve, Pastaj ndoshta pas dy vitesh, nuk po më kujtohet saktë, programi i lajmeve vazhdoi me pesë-gjashtë veta. Nuk e di saktë tani sa veta kanë qenë. Kishte disa emitime, disa emitime të programeve, por më shumë nuk di.

Domethënë ajo pasuria e mëparshme nuk ishte më, prej veprave të mëhershme nuk mbeti asnjë shenjë. Sepse nuk i shfrytëzuan shumë, nuk po bëjnë diçka të re duke u bazuar në arkiva. Ne më të rinjtë vetëm nëse gjejmë ndonjë sponsor, atëherë vet e bën edhe inçizimin edhe regjistrimin. Edhe atëherë çka ndodh? Një video klip del, një CD e ke në dorë, nuk është diçka e lidhur me institucionet.

Pastaj e pash që secilit që ia tregoja diplomën e shkollës së muzikës, askund s'mund të gjeja punë. “E çka është shkolla e muzikës? Asgjë.” Në mënyrë që të bëj diçka të mos rri kot, e regjistrova degën e Orientalistikës në Fakultetin e Filologjisë në Universitet. Për fat të mirë menjëherë u hap një vend pune në Departamentin për të Drejtat e Njeriut, dhe kërkohej një minoritet. Në atë periudhë kam qenë mjaft e zënë. Unë punoja si shërbyese civile në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Këtë vit u bënë dhjetë vite, dhe punoj në një departament shumë të mirë për të drejtat e njeriut. Gjëra të reja mësova.

Në të njëjtën periudhë, unë pata shumë vështirësi, tre fëmijë, familja, të qenit një grua e martuar duke provuar t'i menaxhoja të dyja universitetin dhe punën, ishte mjaft e vështirë, por falë familjes time, ata ishin gjithmonë aty për mua. Ndonjëherë nuk isha në gjendje të gatuaj, nganjëherë isha pa gjumë sepse nuk ishte e lehtë t'i kaloja provimet. Por unë u diplomova me kohë, nuk doja të isha pakicë pa diplomë universitare. Sepse ata mezi presin të thonë, “Shikoni këto minoritetet gjithmonë janë punësuar pa një diplomë universitare”. Kjo është arsyeja pse unë e bëra një premtim dhe u diplomova. Unë jam duke punuar këtu, siç thashë, por përsëri, kishte disa kore të hapura dy ose tre herë, mendoj se quhej kori “Tan”, Meliha Hüdaverdi dhe Sebiha Hüdaverdi ishin organizatore.

Ebru Süleyman: Pas luftës a?

Sevim Baki: Pas luftës filluan të hapen këto koret, merrja pjesë por sistemi i punës së tyre nuk më pëlqente. Me siguri kur njeriu e ka një bagazh, kur gjithmonë është marr me atë punë disa gjëra i vëren kur mungojnë. Si më e reja të përzihesh ti... ku ta di. Kërkonin ndihmë por kur vinte diçka më profesionale nuk te jepnin të drejtë. Nuk mund të duroja dhe u largova. Nja dy herë thash unë fare nuk mund të punoj kështu.

Pastaj disa shoqe filluan të më nxisnin, “Pse ti nuk po formon diçka, pse ti vet nuk po bën diçka?” thash, “Po e formoj, por si?” ende nuk dinim. Unë jam mësuar që gjithmonë të më thërrasin e jo unë të bëj për dikë diçka. Në atë kohë nuk kishim vend, ishte shoqata “Gerçek” ku shumë kam pasur dëshirë të punoj, por kur shkoja dimrit ishte shumë ftohtë, nuk kishte kuzhinë, nuk kishte asgjë, nëse doje një koncert ta organizoje nuk kishte ndihmë, nuk kishte buxhet.

Ndërkohë, neve me të vërtetë na pëlqeu letërsia në universitet dhe filluam të shkonim në Institutin Yunus Emre, ju e dini qendrën kulturore që lidhet me Ambasadën Turke. Pashë që ata ishin të interesuar për projekte të reja, u këshillova me profesorët, dhe ata thanë, “Po, ne me të vërtetë do të donim kështu, ju mund të punoni këtu dhe të organizoni një kor këtu”. Tani, ka pothuajse 20 gra që e dinë gjuhën turke në kor, mbase shumica e tyre janë shqiptare, ato thonë që janë shqiptare, por flasin shumë mirë turqisht. Gjithashtu ato vërtet e pëlqejnë muzikën turke dhe duan ta mësojnë muzikën turke.

Nga muzika e Rumelisë tek artikujt, unë jam duke u përpjekur të zgjedh diçka dhe të krijoj një repertor këngësh që ato tashmë i dinë dhe janë të lehta për t’u kënduar. Për të mësuar muzikën turke, ne e themeluam këtë kor në vitin 2015. E kemi ndërtuar një miqësi vërtet të këndshme atje. Ndonjëherë ne nuk bëjmë prova, por prapë e kemi miqësinë tonë, edhe nëse nuk bëjmë asgjë, miqësia jonë do të mbetet. Ato hyjnë në këtë punë me zemër e me shpirt, prandaj unë përpiqem të organizoj projekte të reja, bëhen veshjet, kemi një CD si potpuri.

Tani po e punojmë një videoklip, por nëse nuk kemi sponzor, vetëm kënga do të publikohet. Kemi pasur koncerte, dhe vërtet dua të falënderoj Institucionin Yunus Emre për mbështetjen e tyre dhe gjithashtu Ministrinë e Kulturës sepse ata gjithashtu hapin projekte të reja nganjëherë dhe na mbështesin me një buxhet të vogël që mund ta përdorim në organizatat tona. Jam vërtet entuziaste për këtë ekip që e kam formuar. Të gjithë janë duke punuar me zemrën dhe shpirtin e tyre pa pritur diçka në këmbim, ashtu si një hobi, shpresoj se një ditë mund të marrim përfitimet e kësaj pune që e kemi bërë.

Ebru Süleyman: Në kor a mund t’i përjetësoni veprat vendore për të cilat folët? Şemsi Mecihan...

Sevim Baki: Jo andej nuk po hyj fare, ashtu jo. Sepse ato janë mdoernizuar shumë, kanë mbetur ashtu të regjistruara, mendoj që të gjitha gjinden në radio. Unë në CD shumë gjëra i kam inçizuar, janë në arkivin tim, le të mbeten tek unë. Por të gjitha nuk mundën t’i nxjerrin shokët, të gjitha janë të regjistruara kështu me pjesëmarrjen e publikut në “Akorde”, këngët e reja, ndoshta sjellin shumë emocion por nuk ka vepra që mund t’i ndëgjoj. Ato këngë kanë qenë të bukura por më moderne.

Kompozimet që këndojmë ndonjëherë janë nga muzika popullore e Prizrenit, muzika popullore e Rumelisë dhe muzika popullore turke, këtë herë po i mësoj edhe sistemet e tipit melodi në muzikën artistike turke sepse burri im është aty afër meje me instrumentin e tij. Për shembull, unë them, “Këtë herë do të këndojmë melodinë *nihavent*¹⁶, në pjesën e dytë do ta përdorim *hiczaz*¹⁷ dhe pastaj llojin e

¹⁶ Notë muzikore që ka ngjashmëri me sol-minoren e muzikës Perëndimore.

¹⁷ E ngjashme me notën “DO” të muzikës Perëndimore.

melodisë *rast*¹⁸. Të gjitha llojet e melodisë e kanë ritmin e tyre, disa prej tyre janë vërtet të ngadalta dhe disa prej tyre janë të shpejta. Kështu që unë jam duke punuar mbi këtë, por ende është shumë emocionuese që ato i dinë të gjitha kompozimet me të cilat po punojmë. Ajo që dua të them është se ato i adhurojnë këngët, dhe unë jam duke u përpjekur t'u mësoj atyre gjëra të veçanta për raste të veçanta.

Njëherë thash pasi që është Ramazani po këndojmë ilahi, e bëjmë një repertor me ilahitë më të bukura. Nëse duhet ulemi e bëjmë një program, kemi menduar që do të bëhet ndonjë program por jo, megjithatë ato mbeten tek ne. Falemnderit prej tyre i gjithë repertori është i printuar në libra, sa herë që na nevojitet ne e marrim dhe e lexojmë atë libër. Siç e dini, këngët e Rumelisë janë më të preferuarat këtu, kjo është arsyeja pse ne duam ta ndryshojmë këtë dhe të kemi më shumë mundësi.

Ebru Süleyman: Sa i përket sallave, ku keni performuar më shumë në Prishtinë? Më parë dhe tani?

Sevim Baki: Në Prishtinë, më shumë më kujtohet “Salla e Kuqe” ku janë mbajtur edhe koncertet tona turke por edhe “Akordet” e festivalet tjera, në fakt vetëm festivali “Akordet”. Këto definitivisht janë mbajtur në Sallën e Kuqe sepse ka një platformë, shkallë, e dini ka qenë sallë, që ka qenë shumë e përshtatshme për shikues. Më kujtohet “Salla e Kuqe” dhe më kujtohet teatri shumë pak. E kam harruar, por ende e thërrasim “Salla e JNA”, që do të thotë ushtria kombëtare, Salla e Ushtrisë Kombëtare Jugosllave. Dhe kjo i përkiste ushtrisë, madje edhe kur OKB e mori atë, ajo ishte në një seksion ushtarak. E mbaj mend atë shumë, “*Gerçek*” e përdorte, komuna lejonte përdorimin e saj.

{Numëron} Aty në “Sallën e Kuqe”, kishte një amfiteatër në “Boro Ramiz”, shumë i lartë i gjelbër, shumë i veçantë, brenda shumë i madh. Ku është shkolla e Kembrixhit tani, shumë njerëz nuk dinë këtë, sepse nuk përdoret më. Ajo gjithashtu u përdor shumë. Kishte një mënyrë për të shkuar atje nga “Salla e Kuqe” nga brenda me shkallët, por ata e mbyllën atë, sepse tani është Shkolla Kembrixh aty. Nëse shkonit poshtë shkallëve aty ishte “Salla e Gjelbër” e veçantë, si një amfiteatri, si një sallë kinemaje, ajo ishte përdorur pak më rrallë. Dhe salla sportive, salla e madhe sportive që mendoj se është quajtur “Nëntori i parë”, tani është përdorur për koncerte të mëdha. Unë nuk e di nëse kemi përdorur ndonjëherë sa “*Gerçek*”, por kam kënduar atje gjatë koncerteve të mëdha dhe në turne, po. Tjetër nuk po më kujtohet.

Ebru Süleyman: Nëse doni na tregoni pak si rini e Prishtinës atëherë ku e kaloni kohën?

Sevim Baki: Çfarë t’ju tregoj për atë kohë rinie, vendtakimin e kishim në shoqatën “*Gerçek*”. Aty shoqëroheshim. Siç thash, në çdo vend të tri motrat shkonim bashkë. Pas provave në “*Gerçek*” dilnim, “Hajde a po shkojmë diku për të pirë kafe?”.

Kishim shokë edhe më të moshuar se ne ata muzikantët, për shembull shokët e grupit të bashkëshortit tim. Aty edhe jam njohur me bashkëshortin. Por në atë kohën kur ishim shokë thoshin, “A po vini?” Dhe ata na dërgonin diku, ka qenë “Grand Hoteli” ku mund ta pije një kafe të mirë, apo “Bozhuri”. Ka qenë restoranti “Rugova” ku është tani “Maxi” aty rrinim shumë. Por mirë, nuk ishte

¹⁸ Një nga llojet kryesore të melodisë së muzikës klasike turke.

keq, neve si të ri nuk na pëlqente shumë por pasi që shkonte shoqëria, dhe gjatë dimrit aty bëhej shumë ngrohtë prandaj shkonim, kurse verës të gjithë të rinjtë...

Ebru Süleyman: Kafeja e “Grand Hotelit” ka qenë e popullarizuar atëherë për të shkuar e për të pirë diçka.

Sevim Baki: Po shumë i popullarizuar ishte kush shkonte në “Grand”. Por mua më dukej shumë e jashtëzakonshme. Unë isha e vogël, e re, çfarë po kërkoja aty? Por kudo që shkonte shoqëria edhe ne shkonim si grup. Pastaj verës në modë ka qenë korzoja. Në korzo dihej cili grup ku qëndronte, të rinjtë ndaheshim në grupe, thoshim, “A po e mbron drurin, çfarë po bëni kështu?”, shoqëri grupe, grupe. Edhe e dinin vendin, të gjithë mblidheshin, aty para “Foto Neshës” ka qenë vendi ynë, i turqve.

Pastaj kur dilnim prej aty, “Ku të shkojmë?”, “Këtë natë po shkojmë në ‘Xhani’ apo në ‘Cannabis’”, më kujtohen këto dy kafiteritë. “Xhani” ka qenë në një kënd te Tre Sheshirat, uleshim jashtë. Kishte plot njerëz, muzikë, aty rrinim. Kurse “Cannabis” ka qenë atje në fund të Kurrizit, u bë lagje e re, kafiteri të reja edhe në “Cannabis” rrinin shumë. Të them të drejtën nuk më pëlqenin shumë këto kafiteri me muzikë, disko. Unë disko klubet nuk i dua, edhe sot po të më pyesësh “Çka të pëlqen”, diçka të lehtë për vete, nuk dëgjoj aq shumë muzikë angleze, me siguri nuk më ka pëlqyer, nuk ka qenë e afërt për mua. Kështu që unë dilja por nuk isha aq e entuziazmuar. Nganjëherë edhe nuk dilja fare. Siç thash periudha e rinisë ka punë, është shkolla, shko-eja në “Gerçek”. Ktheheshim herët, nëna dhe babai nuk na jepnin leje më së shumti deri në nëntë-dhjetë, nuk na lejonin të rrinim më gjatë. Është dashur të ktheheshim herët në shtëpi, domethënë kështu jetë në klube të natës nuk kam pasur.

Ebru Süleyman: Në ato vende me siguri muzikë pop kanë lëshuar?

Sevim Baki: Po edhe gjithnjë anglisht, rock, pop nuk është një stil që më pëlqen mua, nuk kam dëgjuar aq. Prandaj nuk mund të them asgjë. Por si më kujtohet mua këto dy kafiteri kanë qenë më të frekuentuara. Sa herë që dilnim shkonim aty. Dy herë në javë shkonim në shoqatën “Gerçek”, siç thash prej aty pastaj dilnim. Pastaj në raste të tjera, kur kaloja me bashkëshortin më vonë dilja, pas shkollës, pastaj në vende të ndryshme dilnim. Normalisht jo në kafiteri por më shumë në vende më të qeta.

Ebru Süleyman: Fëmijët i keni lindur para luftës apo jo?

Sevim Baki: Po, unë i kam dy djem Mennan dhe Enes, ata janë lindur ‘91-tën dhe ‘96-tën. Në atë kohë, ne duhet të dilnim nga shtëpia jonë bashkë me ta. Kishim fat sepse Kosova ishte bombarduar atë natë kur mbërritëm në Bullgari. Prindërit e mi qëndruan këtu, vjehri im ishte këtu. Ata nuk prisnin diçka të tillë, por ndodhi. Ne qëndruam në Stamboll në zonën e Silivrit për gati dy muaj e gjysmë, falë të afërmve tanë, ata hapën shtëpitë e tyre për ne.

Ebru Süleyman: Domethënë nuk kishte pritshmëri dhe njerëzit nuk dëshironin ta besonin që do të ketë një konflikt apo luftë apo bombardime?

Sevim Baki: Thoshin luftë, por ne pasi që nuk dinim prandaj as nuk mund ta besonim. Sa që thoshim, “Nuk mund të ndodh diçka e tillë, nuk ndodh diçka e tillë, Evropa nuk lejon, Amerika nuk lejon”. Llafet e njerëzve ishin këto, unë isha 22 vjeçe apo 23. Nuk dija gjë lidhur me luftën. Nuk kishim gjë. Ndodhi,

nëna dhe babai mjaft bombardime i kanë përjetuar, madje një natë ishin thyer të gjitha dritaret e shtëpisë...

Ebru Süleyman: Me siguri postën [e kanë bombarduar]?

Sevim Baki: Po, gjithashtu, një makinë në lagjen tonë kishte shpërthyer. Prindërit e mi ishin të tmerruar dhe të stresuar, por ata nuk panë shumë të këqija. Edhe dikush u përpoq ta plaçkis shtëpinë... ndoshta fqinjët ose nuk e di, kur panë prindërit e mi, ata u larguan. Sepse ata qëndruan aty për të mbrojtur shtëpinë dhe shumë të afërm tanë gjithashtu qëndruan për të njëjtën arsye. Mbaj mend që motra ime ishte shtatzënë, ne e morëm atë me makinën tonë në minutën e fundit, dhe ajo e lindi fëmijën e saj në Turqi.

Pas kësaj, gjithçka ishte në rregull, sigurisht që kishim vështirësi për dy muaj e gjysmë. Menxi prisnim që të ktheheshim. Nuk kam përjetuar asgjë të keqe në shtëpinë time. Kishte disa të afërm të burrit tim në shtëpinë tonë, sepse u nxorrën jashtë shtëpisë së tyre, ata kishin kërkuar një vend bosh për të qëndruar. Edhe vjehri im ishte aty kur ata erdhën, kështu që ai u la atyre shtëpinë. As gjilpëra nuk mungonte, ata nuk e plaçkitën apo sulmuan shtëpinë.

Në punë nuk u kthyem, mendonim që pasi ka përfunduar lufta do të kthehet gjithçka siç ka qenë. Por as në ëndërr nuk mendoja që do të bëhej kështu. Çdo derë na u mbyll para hundës, askujt nuk ia ndjeu për ndjenjat tona. Për shembull unë dhe bashkëshorti kemi punuar në të njëjtin institut, të dy betëm pa punë. I kishim fëmijët, unë punoja si përgjegjëse në radio dhe në orkestër. Por sa herë që shkoja në radio, "Mbaroi këtu nuk ka gjë, kur të kthehen të gjithë atëherë edhe ju do të ktheheni!". Ne prisnim një përgjigje nga autoritetet, por asgjë nuk ndodhi kurrë. Gjithçka që ishte e vjetër ishte fshirë, njësitë e reja ishin të hapura dhe u punësua personeli i ri, pesë ose gjashtë veta.

Ebru Süleyman: Çka u bë me kontributin që ju e keni dhënë në radio?

Sevim Baki: Asgjë, unë kam arritur të gjej vetëm dokumentet që kam punuar disa vite më parë. Kam punuar për nëntë vjet por vetëm gjashtë vjet janë regjistruar. Aq shumë vite kam punuar të fitoj një ditë, për hir të atyre viteve ta kem një stazh. Vetëm aq, jo më shumë.

Përshkak se bashkëshorti im është muzikant ai punoi, nuk mbetëm kurrë keq, gjithmonë gjente diçka madje, filluam financiarisht edhe më mirë të qëndrojmë. Ndoshta ishte për të mirë, por të punosh në një institucion dhe të përfaqësosh një komb, ishte diçka tjetër, ishte një privilegj. Atëherë ngadalë e kuptoni se duhet të ngriheni dhe të bëni diçka për veten tuaj. Nëse doni të bëni diçka, duhet të organizoni një projekt, të aplikoni për fonde dhe ta bëni atë të ndodhë. Tani ky projekt mund të mos ketë shumë ndjekës por ne po mundohemi që gradualisht të arrijmë sukses.

Ebru Süleyman: Duhet të merret iniciativa...

Sevim Baki: Iniciativë po marr por nuk kam përkrahje. E vështirë të gjesh përkrahje. Ne ishim mësuar të merrnim mbështetjen nga shteti në institucionin tonë. Por tani ne kemi partinë tonë politike, nuk e di nga vjen buxheti i tyre, por askush nuk interesohet. Disa vlera humbasin për shkak të mosinteresimit. Të gjithë përpiqen të bëjnë diçka unike, të gjithë e dinë punën tuaj dhe përpiqen t'ju

drejtojnë, por për fat të keq, burri im dhe unë, ne nuk kemi lejuar diçka të tillë dhe unë mendoj se kjo është arsyeja pse ne nuk mundëm të përparojmë më shumë këtu.

Ebru Süleyman: Me siguri përkrahja stabile e shtetit është shumë e rëndësishme për art, t’ju jepet hapësirë artistëve, apo jo?

Sevim Baki: Madje ishte e obligueshme që të hap. Thash që po të kishte diçka në shqip 80 për qind, pesë për qind apo dhjetë përqind duhej të ishte me pjesëmarrje të serbëve dhe turqve. Unë mendoj se duhej të ishte kështu në institucionet shtetërore, të ketë radio dhe televizion. Por fondet nuk janë duke u përdorur për ne, kohët e fundit kam kuptuar që programet e Vitit të Ri u bënë aq monotone sa që për këtë arsye i anuluan, nuk do të ketë më programe të Vitit të Ri të mbajtura në kanalin “RTK”.

Deri vitin e kaluar na thërrisnin “A ka diçka të re?” Për shembull ata neve na pyesnin pastaj unë fillova t’i pyes, “Cilat janë mundësitë, çka po na jep ti neve që ne të vijmë?” Domethënë asgjë nuk po na jepin, shko me veturën tënde, me shpenzime personale, “As një kafe” tha “nuk mund t’ju jepim”. Atëherë pse? Studioli ishin shumë të thjeshta, nuk ka as grimere as frizere. E ti patjetër nëse i ke aty 20 gra, duhet të paktën një frizere ta kesh aty. Skenat ishin të tmerrshme, sa i përket skenografisë nuk kishte gjë. Duke e krahasuar me programet e tjera shqiptare në “RTK”, unë nuk mendoj se është e drejtë. Ata kanë cilësinë më të mirë në gjithçka, por pakicat si boshnjakët, romët, turqit, ata kanë kushte të këqija. Prandaj unë më nuk do të marr pjesë, asnjëherë më. Nëse do të bëj diçka, ndoshta e gjej një sponzor, do të mundohem dhe do ta shfaq një program të bukur. Nuk jemi të detyruar të bëjmë diçka nëse nuk i kemi kushtet.

Ne kemi njerëz që na menaxhojnë dhe marrin me qira hapësira të mira pune vetëm për të qëndruar pranë nesh, si një komitet turk, ata duhet të nxitojnë dhe të bëjnë diçka në emër të komunitetit turk këtu. Unë mendoj se kemi bërë shumë në emër të turqve, por vlerat askund nuk mund të gjenden. Domethënë ne prapë vazhdojmë por askund nuk po të afrohet, nuk po ta hap një rrugë që ti të mund të punosh, nuk e di a po më kuptoni?

Ebru Süleyman: Pra, arti është bërë diçka që ju bëni vetëm për veten tuaj? Nuk po depërton te njerëzit.

Sevim Baki: Po, nuk po depërton. Unë mendoj se kam bërë diçka, veçanërisht kohët e fundit, kam provuar vazhdimisht, por akoma jemi në të njëjtin vend. Nuk besoj se do të heq dorë ndonjëherë për shkak të mbështetjes dhe dëshirës së grave, ato gjithmonë më inkurajojnë, kështu që gjithmonë do të përpiqem të bëj diçka për hir të tyre

Ebru Süleyman: Falemnderit shumë për kohën dhe tregimet.

Sevim Baki: Shpresoj që është bërë një program i mirë dhe shpresoj që këto vlera do t’ju hyjnë në punë.

Ebru Süleyman: Shpresojmë edhe ne që do të regjistrohen dhe të kalojnë në histori.

Sevim Baki: InshAllah, falemnderit.